



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria Teknike
(Sektor i Tatimeve Indirekte)

Nr. 9355 Prot.

Tiranë, më 22/07/2008

LËNDA: Dërgohet Qarkore

Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj

TIRANË

Dega e tatimeve

Nr. 1, Datë 22/07/2008

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pas njohjes me problemet e prezantuara nga organizatat jofitimprurëse si dhe duke konstatuar mangësi në administrimin tatimor, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.9856, datë 26.12.2007 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve që kryhen nga organizatat jofitimprurëse, status të cilin e përfitojnë në zbatim të Ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar, si dhe në zbatimin korrekt të pikës 8.5 të Udhëzimit Nr.17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në” lidhur me trajtimin e TVSH-së, ju orienton si më poshtë:

1. Të Përgjithshme

Ligji Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” lejon OJF-të të kryejnë aktivitete tregtare, prodhuese, shërbimi në funksion të objektit dhe qëllimit për të cilin është krijuar OJF-ja. Organizatat jo fitimprurëse të themeluara, të njohura dhe të regjistruara që ushtrojnë veprimtari të ndryshme sipas statutit të miratuar prej tyre, përveç organizatave që kryejnë furnizime fetare dhe filozofike që pas datës 5 Shkurt 2008 konsiderohen si persona të tatueshëm, sipas kuptimit të nenit 2, të Ligjit. Veprimtari jofitimprurëse kuptohet çdo veprimtari ekonomike ose joekonomike me kusht që të ardhurat ose pasuritë e organizatave jofitimprurëse, kur ka të tilla, të përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e organizatës.

Në varësi të mënyrës së organizimit, organizatat jofitimprurëse ndahen në:

- organizata jofitimprurëse me anëtarësi (shoqatat);
- organizata jofitimprurëse pa anëtarësi (fondacionet dhe qendrat);

Në varësi të vendit të regjistrimit të tyre, organizatat jofitimprurëse ndahen në:

1. organizata jofitimprurëse vendase (themelohen, njihen dhe regjistrohen sipas ligjit shqiptar);
2. organizata jofitimprurëse të huaja (themelohen, njihen dhe regjistrohen sipas ligjit të një shteti të huaj, por që regjistrohen sipas ligjit shqiptar kur ushtrojnë veprimtari në Shqipëri);

Kohëzgjatja e veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse dhe rregullat për ndryshimin e saj caktohen në statutin e saj.

2. Fusha e veprimtarisë ekonomike e organizatave jofitimprurëse

Organizata jofitimprurëse, për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të ushtrojë veprimtari ekonomike. Nëse organizata jofitimprurëse, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, realizon fitime, ato duhet të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

Organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të marrin pjesë si të gjithë personat e tjerë juridikë në fushën e sipërmarrjes, të tenderimit dhe të prokurimit të granteve, të kontraktimeve dhe të shitblerjeve nga ana e organeve shtetërore të shërbimeve publike, të mallrave dhe të pasurive publike, si dhe të transferimit të shërbimeve publike dhe pasurive përkatëse nga sektori publik tek organizatat jofitimprurëse. Organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë gjithashtu të kryejnë veprimtari për mbledhjen e fondeve, për t'i përdorur për përmbushjen e qëllimeve dhe objektit të veprimtarisë së tyre ose për të mbështetur qëllimet dhe veprimtaritë e organizatave të tjera jofitimprurëse. Rregullat për mbledhjen publike të fondeve përcaktohen me ligj të veçantë.

Marrëdhëniet financiare, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella me donatorët realizohen në përputhje me marrëveshjet përkatëse, por duke respektuar kërkesat e statutit të organizatës jofitimprurëse dhe të këtij ligji.

Ashtu si dhe për shoqëritë tregtare dhe gjithë personat e tjerë të tatueshëm, ligji “Për OJF-të”, ndalon furnizimet e ndihmave materiale ose financiare që jepen për qëllime të kundërligjshme ose që sigurohen nëpërmjet burimeve të kundërligjshme.

3. Trajtimi i TVSH-së për të ardhurat e përfituara prej saj

Furnizimet e tatueshme të OJF-ve konsiderohen furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, si në blerje brenda vendit dhe nga importi, po ashtu dhe në shitje brenda vendit dhe për eksport apo me shkallë 0%, pa u kufizuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, nëse në ligj nuk përcaktohet ndryshe.

Organizatat jo fitimprurëse që konsiderohen nga ligji si persona të tatueshëm do të kryejnë furnizime në blerje të përjashtuara në rastet e mëposhtme:

- nga organizata jo fitimprurëse që janë të përjashtuara nga Ligji;

- nga persona, furnizimet e të cilëve janë të përjashtuara nga Ligji;

Në kuptim të Nenit 50, të Ligjit Nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, organizatat jofitimprurëse kanë të drejtën të mbartin shumën e mbetur si kreditim tatimor për periudhën pasardhëse tatimore në bazë, nëse kreditimi i tatimit për një periudhe tatimore është me i madh se TVSH i zbatuar për atë periudhë. Rimbursimi i kësaj shume kreditore bazohet sipas përshkrimit në pikën 20. të Udhëzimit Nr.17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”.

Burimet e të ardhurave të organizatës jofitimprurëse janë të ardhurat nga:

- kuotizacioni kur ka të tilla;
- fonde dhe grante;
- donacionet e ofruara nga subjektet private ose publike, vendas ose të huaj;
- të ardhurat nga veprimtaria ekonomike, si dhe;
- të ardhura nga shfrytëzimi i pasurisë (aktiveve) në pronësi të organizatës jofitimprurëse.

Ne cdo rast që OJF-ja perfiton fonde, grante, sponsorizime, kuota anetaresie dhe të ardhura të ngjashme, ato duhet të përdoren në përputhje me statutin. Përndryshe, këto fonde do të konsiderohen si furnizime kundrejt pagese.

Në rastin kur OJF-të zotërojnë aktive të tilla si: vende arti, kulturore, shkencore, parqe e të ngjashme për gjithë vizitorët dhe konsumatorët e ndryshëm do të faturohet shërbim në shkallën standarte me 20% TVSH. Mënyra e faturimit të këtij furnizimi shërbimi do të zbatohet njësoj si ndodh në raste të ngjashme të veprimtarive ekonomike fitimprurëse.

- Në rastin e përfitimit të shumave të dhuruara, kur donatorët kanë kryer një dhurim që nuk kushtëzon që të përfitojë (furnizohet) në këmbim me asnjë shërbim apo mall nga OJF-ja, atëherë ky dhurim parash, malli ose shërbimi nuk konsiderohet si një furnizim i tatueshëm dhe nuk aplikohet asnjëra nga shkallët tatimore. Nëse, dhurimi kushtëzohet që të furnizohet në këmbim me para, mall apo shërbim të furnizuar nga OJF-ja, atëherë ky furnizim i bërë nga donatori është si çdo furnizim tjetër i tatueshëm dhe po ashtu furnizimi i bërë nga OJF-ja në këmbim të vlerës së dhurimit. Përfitimi i shumave në formë sponsorizimi dhe nëse OJF-ja kryen një furnizim shërbimi ose malli në drejtim të sponsorit, atëherë sponsorizimi i dhënë është si çdo furnizim tjetër i tatueshëm dhe po ashtu është dhe furnizimi i bërë nga OJF-ja në këmbim të vlerës së fondit ose grantit. Të dy furnizimet taten në ndara me shkallë tatimore 20%.

- Në rastin e kryerjes së furnizimeve të shërbimit të publicitetit për një person tjetër, të bëra nga OJF-të gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre ekonomike do të konsiderohet si një furnizim shërbimi të tatueshëm me shkallën tatimore standarte 20%.

- Furnizimi i shërbimeve nga OJF-ja që kryen veprimtari ekonomike në sektorin shëndetësor, arsimor, kulturor, sportiv, shkencor janë furnizime të tatueshme në shkallën standarte 20%. Furnizimi i shërbimeve i lidhur me kryerjen e këtyre furnizimeve (furnizim i përzier) është furnizim i tatueshëm në shkallën standarte 20%. P.sh. transporti me abulancë i të sëmurit, transporti i nxënësve dhe studentëve, ushqimi në menca janë furnizime shërbimi të tatueshme.

- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme kulturore, artistike, sportive, shkencore me qëllim mbledhje fondesh në emër të OJF-së dhe mundet/ose jo të paguajnë shpenzime udhëtimi, ushqimi, qëndrimi në hotel për pjesëmarrësit nuk janë furnizime të tatueshme pasi nuk kemi të bëjmë me një furnizim në këmbim të pagesës apo kundërvlerë tjetër të ngjashme, pra sipas nenit 18 të ligjit.

- Në rast se çdo fond apo grant i dhënë kushtëzohet që të marrë si këmbim një furnizim në para, mall apo shërbim, atehere ky fond është si çdo furnizim tjetër i tatueshëm dhe po ashtu është dhe furnizimi i bërë nga OJF-ja në këmbim të vlerës së fondit ose grantit. Të dy furnizimet taten të ndara me shkallë tatimore 20%.

Kur një OJF krijon të ardhura nëpërmjet kuotizacioneve të anëtarësisë, këto kuota konsiderohen si furnizime të patatueshme, për sa kohë ato janë në përputhje me statutin e OJF-së dhe nëse anëtarët janë të punësuar në OJF. Por, nëse nëpërmjet dhënies së kuotave, anëtarët përfitojnë furnizim shërbimesh apo mallrash në këmbim, furnizimi i shërbimeve prej OJF-së konsiderohet si furnizim kundrejt pagesës së reduktuar shërbimi ose malli në shkallën standarte 20%.

Në rastin kur, furnizimi i shërbimeve apo mallrave është furnizim i përzier, atëherë do të zbatohen parimet e Nenit 10 të Ligjit Nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”.

Në rastin kur OJF-ja i furnizon punonjësve të vet mallra ose shërbime, të cilat janë pjesë e furnizimeve të tatueshme, atëherë këto furnizime konsiderohen si furnizime kundrejt pagesës.

Në rastet e tjera të papërmendura më sipër, për furnizimet e kryera, OJF-të do të trajtohen dhe do të veprojnë sipas procedurave që zbaton një person i tatueshëm duke u orientuar nga parimet bazë të Ligjit Nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Arben SEFGJINI